



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:081195

Datë: 08.11.2021

Numri i dokumentit: 02372598

P.nr.1019/19

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin Ertan Sejfulla, me praktikantin Dardan Ademi, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S.R, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PP/IL.nr.3163/18 e dt.18.03.2019, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të mbajtur më datë 02.11.2021, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i shtetit Rukije Sheshivari dhe i akuzuari, në të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.08.11.2021 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari S.R**, nga i ati R, nëna Sh, e gjinisë B, i lindur m....., në fsh.P, K. F.. K..., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

I akuzuari, pasi që ka pasur mosmarrëveshje me të bijën e tij- të miturën V.R lidhur me dëshirën e saj që të ndahet nga i fejuari dhe të mos martohet, i njëjti me dashje ka ushtruar dhunë fizike, duke e rrahur për ta detyruar që të mos ndahet nga i fejuari i saj, ku e mitura si pasojë e dhunës ka ikur nga shtëpia prej datës .., deri me dt....., rreth orës 01:35, kur është lajmëruar në stacionin policor, me ç'rast i është ofruar ndihma mjekësore, e në bazë të raportit mjekësor është konstatuar se e njëjta ka pësuar ndrydhje në shpatullën e majtë dhe skuqje në shputën e djathtë, të cilat paraqesin lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 7, 17, 21, 41, 49, 50, 51, 52, 73 dhe 188 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 248 dhe 365, të KPP-së i shqipton:

## DËNIM BURGIMI ME KUSHT

**Të akuzuarit S.R.**, i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti, në qoftë se i akuzuari gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë **(30.00) €**, për ekspertizënmjeko-ligjore në shumën prej njëzet **(20.00) €** si dhe në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumën prej tridhjetë **(30.00) €**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

Pala e dëmtuar V. R. nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

## A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/IL.nr.3163/18 e dt.18.03.2019, ndaj të akuzuarit S.R, për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të datës 02.11.2021, të akuzuarit me lejen e gjykatës, i është dhënë fjala, ku i njëjti ka deklaruar se pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, duke shtuar se pendohet për veprën e kryer, është i gjendjes së dobët ekonomike, është mbajtës i vetëm i familjes nëntë anëtarëshe, kjo vepër nuk është përsëritur më dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërisë vepra të tilla në të ardhmen.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga i akuzuari, Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë sepse ky pranim i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës, si dhe bazë ligjore në bazë të nenit 248 të KPRK-së dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ta vlerësojë si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit.

Pas deklarimit të akuzuarit se ndihet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga prokuroria, gjykata me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar: Meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet, kërkojmë nga gjykata që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, propozojmë që me rastin e marrjes së vendimit në lidhje me dënimin, të merret për bazë si rrethanë lehtësuese pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari ka deklaruar se: E pranoj fajësinë për veprën për të cilën akuzohem, jam penduar për veprën që ka ndodh, i premtoj gjykatës se më nuk do të përsërisë vepra të tilla.

Gjykata krahas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, gjeti se edhe nga shkresat e lëndës, në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si

në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprë penale të kryer, pendimin e tij për rastin, mbajtës i vetëm i familjes dhe faktin se i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtor, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, e që konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPP-së.

Vendimi lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 39 par 3, pika 3.1, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr 05/L036).

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal  
P.nr.1019/19, datë 08.11.2021

Praktikanti,  
Dardan Ademi

---

Gjyqtari,  
Ertan Sejfulla

---

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.